



DEMOCRACYPLUS

MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 06/L-113 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE AGJENCIVE TË PAVARURA

TETOR, 2020



MONITORIMI I ZBATIMIT

TË LIGJIT NR. 06/L-113 PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE DHE AGJENCIVE TË PAVARURA

Falënderojmë **Ambasadën Holandeze në Kosovë** për përkrahjen financiare në këtë iniciativë përmes programit **MATRA**.

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e **Ambasadës Holandeze**.

Ky raport është përgatitur nga **Visar Rushiti**.
Me kontribut nga **Arta Sejdiu** dhe **Krenare Rushiti**.

Design and Layout: **Envinion**

Për më shumë informata vizitoni **www.dplus.org**

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE	6
HYRJE.....	7
METODOLOGJIA	8
FAZAT E SHQYRTIMIT TË LIGJIT NË KUVEND	8
MIRATIMI NGA QEVERIA I AKTEVE NËNLIGJORE QË KËRKOHEN ME LIGJ	10
ADRESIMI NGA QEVERIA/MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR ADMINISTRATË PUBLIKE I OBLIGIMEVE PROGRAMORE QË KËRKOHEN ME LIGJ.....	11
RACIONALIZIMI I AGJENCIVE	12
HARTIMI DHE MIRATIMI I RREGULLOREVE PËR ORGANIZIM TË BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIM TË VENDEVE TË PUNËS NË MINISTRI DHE AGJENCI EKZEKUTIVE.....	13
MINISTRITË	14
AGJENCITË EKZEKUTIVE	15
AGJENCITË E PAVARURA	19
HARTIMI DHE MIRATIMI I RREGULLOREVE PËR ORGANIZIM TË BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIM TË VENDEVE TË PUNËS	19
HARTIMI DHE MIRATIMI I PLANEVE VJETORE TË PERFORMANCËS TË AGJENCIVE TË PAVARURA SIPAS LIGJIT	21
HARTIMI, MIRATIMI DHE PUBLIKIMI I RAPORTEVE VJETORE TË PUNËS I AGJENCIVE TË PAVARURA SIPAS LIGJIT	23
REKOMANDIME	24

Përmbledhje e të gjeturave

- Nga 16 ministri gjithsej, vetëm Ministria e Mbrojtjes ka të miratuar në Qeveri Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, nëntë ministri janë në fazë ose të hartimit të rregullores në grup punues ose e njëjta gjendet në fazën e konsultimeve publike derisa gjashtë ministri tjera nuk kanë kthyer përgjigje;
- Nga 46 agjenci ekzekutive gjithsej në kuadër të ministrive, asnjë nga to nuk e ka të miratuar në Qeveri Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Gjashtë agjenci nuk e kanë filluar këtë proces, 18 agjenci nuk kanë kthyer përgjigje derisa 21 agjenci tjera janë në fazën ose të hartimit të rregullores në grup punues ose e njëjta gjendet në fazën e konsultimeve publike. Instituti i Mjekësisë Ligjore si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e ka miratuar këtë rregullore mirëpo e njëjta është vetëm e nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë por jo edhe e miratuar në Qeveri;
- Agjencitë ekzekutive janë fare pak të njoftuara me përmbajtjen e ligjit, konkretisht për obligimin që agjencitë ekzekutive duhet të hartojnë rregullore për organizim të brendshëm ndaras nga ministritë (apo ministria amë) dhe se miratimi i tyre është po ashtu i ndarë;
- Nga 17 agjenci të pavarura (duke përjashtuar institucionet e pavarura kushtetuese), asnjë prej tyre nuk ka miratuar rregullore për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës duke u bazuar edhe në ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. Tetë agjenci janë në proces qoftë të hartimit të rregullores në grup punues qoftë në proces të konsultimeve publike, një nuk ka nisur këtë proces dhe pesë të tjera nuk kanë kthyer përgjigje. Edhe pse dy të tjera kanë deklaruar se i kanë miratuar ato, të njëjtat nuk janë të bazuara edhe në ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura.
- Agjencitë e pavarura (përfshirë ato rregullatorë) janë fare pak të njoftuara që fushëveprimi i ligjit për administratën shtetërore tani përfshinë edhe agjencitë e pavarura ndryshe nga ligji paraprak për administratën shtetërore. Si pasojë e kësaj, këto agjenci janë fare pak të njoftuara që në bazë të këtij ligji, kërkohet që agjencitë e pavarura të dërgojnë në komisionin përgjegjës parlamentar plan vjetor të performancës për vitin vijues i cili dakordohet me komision më së largu deri me 31 dhjetor të vitit aktual. Po ashtu, raporti i punës kërkohet tash e tutje të jetë mbi caqet dhe objektivat e vendosura paraprakisht në planin vjetor të performancës dhe se komisioni përgjegjës harton pastaj raport vlerësimi të performancës për punën e agjencisë i cili së bashku me një projektrezolutë të hartuar po ashtu nga komisioni përgjegjës votohen nga Kuvendi;
- Zbatimi i planit të veprimit për racionalizimin e agjencive ka ngecur si pasojë e mungesës së vullnetit politik për të zbatuar këtë plan. Koncept dokumenti dhe projektligji për fazën e parë të racionalizimit të agjencive kanë kaluar fazat e konsultimeve në 2018 (koncepti) dhe 2019 (projektligji) mirëpo nuk ka kaluar për miratim në Qeveri për të kaluar pastaj në Kuvend për miratim përfundimtarë;
- Sa i përket hartimit të planit vjetor të performancës nga agjencitë e pavarura, tetë agjenci kanë plan të punës për vitin 2020, tre tjera nuk kanë plan të punës për këtë vit derisa gjashtë agjenci tjera nuk kanë kthyer përgjigje;
- Sa i përket hartimit të raportit vjetor, pesë agjenci kanë raportuar se raporti vjetor i tyre është diskutuar dhe miratuar në komision dhe i njëjti është publikuar, shtatë agjenci të pavarura nuk kanë kthyer përgjigje, kurse raportet e tri agjencive të tjera nuk janë diskutuar, as miratuar dhe as nuk janë publikuar. Në anën tjetër, Autoriteti Rregullator i Hekurudhave ka deklaruar se raporti vjetor është diskutuar në komision, nuk është miratuar por i njëjti është publikuar. Pastaj, Trusti i Kursimeve Pensionale ka raportuar se raporti vjetor është diskutuar në komision, nuk është miratuar ende dhe se i njëjti ende nuk është publikuar.

Hyrje

Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura¹ është një nga tri ligjet e pakos së reformës së administratës publike i cili ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2019. Dy ligjet tjera si pjesë e kësaj pako janë edhe Ligji për zyrtarët publik dhe Ligji i pagave në sektorin publik i cili është shpallur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese më 30 qershor 2020. Po në këtë datë, Gjykata Kushtetuese ka dhënë aktgjykim² edhe mbi vlerësimin e kushtetutshmërisë së disa neneve të Ligjit për zyrtarët publik meqë rast ka vlerësuar se një numër i neneve të këtij ligji nuk janë në përputhshmëri me një numër të neneve të Kushtetutës sepse cenojnë pavarësinë e disa institucioneve të pavarura kushtetuese derisa pjesa tjetër e ligjit mbetet në fuqi.

Ligji përkatës ka fushëveprim më të gjerë se sa Ligji për administratën shtetërore (i shfuqizuar nga ligji përkatës) ngase në mes tjerash përfshinë rregullimin edhe të agjencive të pavarura të themeluara në bazë të Nenit 142 të Kushtetutës. Agjencitë e pavarura janë të themeluara me ligje të veçanta të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, mirëpo deri me miratimin e këtij ligji, nuk ka pasur një ligj horizontal i cili vendos disa rregulla kornizë për të gjitha këto agjenci e pastaj ligjet e veçanta të tyre bëjnë rregullimin më specifik mbi funksionet, përgjegjësitë, organizimin dhe komplet qeverisjen e tyre. Pra, ky ligj shfuqizon Ligjin për administratën shtetërore i cili ka qenë në fuqi nga viti 2010, ndërsa ministritë, agjencitë ekzekutive dhe agjencitë e pavarura janë të obliguara të përshtatin organizimin, sistematizimin e vendeve të punës, transparencën, raportimin dhe llogaridhënien sipas këtij ligji.

Ligji në fjalë dhe legjislacioni sekondar që del prej tij, nxjerrin një numër të obligimeve për ministritë, tri tipet e agjencive (agjencitë ekzekutive në kuadër të Ministrive, agjencitë rregullatore në kuadër të Qeverisë dhe ato të pavarura nën Kuvendin e Kosovës) që kanë të bëjnë me: 1) hartimin dhe miratimin e Rregulloreve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës (obligim për ministritë

dhe tri tipet e agjencive); dhe 2) hartimin e planit vjetor të performancës (obligim për tri tipet e agjencive e pavarura); 3) prezantimi në komisionin përkatës të Kuvendit të raportit vjetor të punës për agjencitë e pavarura; dhe 4) publikimi i këtij raporti në funksion të llogaridhënies ndaj publikut për të gjitha agjencitë. Në këtë kuadër, risi e ligjit përkatës është kërkesa ndaj agjencive të pavarura për të hartuar plan vjetor të performancës dhe atë të dakorduar me komisionin përkatës parlamentar dhe më pas raportimi mbi arritjen e objektivave sipas atij plani. Ligji përkatës për të gjitha këto ka vendosur një kornizë kohore se kur paraqitet plani vjetor dhe darkodohet me komisionin e pastaj edhe kur prezantohet në komision. Megjithatë, nëse tani nuk mund të kërkohet raport vjetor për agjencitë e pavarura mbi zbatimin e planit vjetor të performancës për 2019, sepse vet ligji ka hyrë në fuqi në mars 2019, ajo që mund të kërkohet nga këto agjenci është nëse kanë përgatitur plan vjetor të performancës për vitin 2020 dhe nëse objektivat që dalin nga ky plan janë dakorduar me komisionin përkatës parlamentar. Pas marsit 2021, për këto agjenci do të mund të kërkohet pastaj hartimi i raportit vjetor konform planit të punës për 2020 dhe raportimi i tij në komision parlamentar.

1 Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura: <https://bit.ly/30gDGlp>

2 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, rasti K0203/19 dhënë me 9 korrik 2020: <https://bit.ly/343Am4C>

Metodologjia

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura është bërë duke analizuar obligimet që dalin nga ligji përkatës për Qeverinë, ministrinë, agjencitë ekzekutive në kuadër të ministrive dhe agjencive të pavarura që raportojnë në Kuvend të Kosovës. Procesi i hulumtimit në këtë aspekt është bërë përmes këtyre metodave: 1) hulumtimit online mbi atë nëse Qeveria dhe ministrisë kanë nxjerrë aktet nënligjore që kërkohen me ligjin përkatës; 2) kërkesave për qasje në dokumente publike drejtuar në 16 ministri, 46 agjenci ekzekutive në kuadër të ministrive dhe 17 agjencive të pavarura (duke përjashtuar institucionet e pavarura dhe institucionit e sektorit gjyqësor); dhe 3) takimeve individuale në institucionet relevante në këtë fushë si Ministria e Punëve të Brendshme (përgjegjëse për administratë publike), Ministria e Financave, Kuvendi i Kosovës dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.

Përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, institucionet e cekura më lartë janë pyetur mbi statusin e hartimit të rregulloreve për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës dhe në cilën fazë të hartimit janë ato, apo nëse janë miratuar ato. Agjencitë e pavarura, përveç pyetjes mbi rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, janë pyetur edhe nëse: 1) kanë hartuar plan vjetor të punës për vitin aktual, nëse jo, cilat janë pengesat; dhe 2) nëse kanë hartuar raport të punës për vitin paraprak dhe cili është statusi i raportit, diskutuar në komision, miratuar në komision dhe nëse i njëjti është publik. Kërkesa për qasje është dërguar tek këto institucione me datë 17 shtator dhe përgjigjet janë pranuar deri me datë 5 tetor 2020.

Takimet e organizuara pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet që kanë dhënë përgjigje, janë zhvilluar për të hulumtuar procesin e dhënies së pëlqimeve ndaj ministrive, agjencive ekzekutive dhe të pavarura. Po ashtu, takime janë

zhvilluar edhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit sa i përket marrjes së mendimit këshillimor nga agjencitë e pavarura para miratimit nga to të rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Kuvendin e Kosovës, përkatësisht zyrtarit ndërlidhës të kuvendit me agjencitë e pavarura mbi statusin e raportimit të agjencive të pavarura në komisionet përkatëse të Kuvendit.

Fazat e shqyrtimit të ligjit në Kuvend

Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura është shqyrtuar në parim në komisionin funksional, pra në Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media me 8 tetor 2018. Komisioni në këtë mbledhje ka votuar unanimisht për miratimin e projektligjit përkatës dhe ka nxjerre rekomandim për Kuvendin që të miratohet në parim projektligji në fjalë dhe arsyetimin për këtë rekomandim e kishte dhënë deputeti dhe Kryetari i këtij komisioni, z. Nait Hasani.³ Projektligji ka kaluar në shqyrtim të parë në seancë të Kuvendit me 18 tetor 2018⁴ derisa është miratuar nga deputetët në shqyrtimin e dytë të tij të mbajtur me 02 shkurt 2019.⁵

Bazuar në transkriptën e seancës së Kuvendit të datës 2 shkurt 2019, mësohet se projektligji ka pasur disa amendamente të dhëna nga deputetët në mes të dy shqyrtimeve nga Kuvendit të cilat janë votuar bashkërisht dhe kanë marrë pëlqimin e komisionit funksional. Afati deri në hyrjen e tij në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare është caktuar një (1) muaj kështu që pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare më 1 mars 2019, i njëjti ka hyrë në fuqi më 1 prill 2019.⁶

3 Kuvendi i Republikës së Kosovës, legjislatura VI, sesioni vjeshtor, Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, mbledhja nr. 37, datë 8 tetor 2018: <https://bit.ly/3mZjETI>

4 Kuvendi i Republikës së Kosovës, transkript i mbledhjeve plenare të mbajtur me 18, 19, 25 tetor dhe 2 nëntor 2018: <https://bit.ly/3k0tcYy>

5 Kuvendi i Republikës së Kosovës, transkript i mbledhjes plenare të Kuvendit të mbajtur më 2 dhe 3 shkurt 2019: <https://bit.ly/3icB4BA>

6 Shih fusnotën 1 më lartë për datën e publikimit në Gazetën Zyrtare dhe afatin e hyrjes në fuqi të tij.

Procesi i hulumtimit në këtë aspekt është bërë përmes këtyre metodave:

- 1 hulumtimit online mbi atë nëse Qeveria dhe ministrisë kanë nxjerrë aktet nënligjore që kërkohen me ligjin përkatës;
- 2 kërkesave për qasje në dokumente publike drejtuar në 16 ministri, 46 agjenci ekzekutive në kuadër të ministrive dhe 17 agjencive të pavarura (duke përjashtuar institucionet e pavarura dhe institucionit e sektorit gjyqësor)
- 3 takimeve individuale në institucionet relevante në këtë fushë si Ministria e Punëve të Brendshme (përgjegjëse për administratë publike), Ministria e Financave, Kuvendi i Kosovës dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.

Agjencitë e pavarura, përveç pyetjes mbi rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, janë pyetur edhe nëse:

- 1 kanë hartuar plan vjetor të punës për vitin aktual, nëse jo, cilat janë pengesat
- 2 nëse kanë hartuar raport të punës për vitin paraprak dhe cili është statusi i raportit, diskutuar në komision, miratuar në komision dhe nëse i njëjti është publik.

Kërkesa për qasje është dërguar tek këto institucione me datë 17 shtator dhe përgjigjet janë pranuar deri me datë 5 tetor 2020. Përgjigjet e pranuar pas kësaj date nuk janë marr parasysh.

Miratimi nga Qeveria i akteve nënligjore që kërkohen me ligj

Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura nxjerrë një numër të obligimeve për ministritë, tri tipet e agjencive të cilat përveç hartimit të rregulloreve individuale për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, bien në fushat e hartimit të planeve vjetore të performancës dhe raporteve vjetore sipas tyre. Në anën tjetër, janë disa akte nënligjore të

cilat janë obligim i Qeverisë e në bazë të të cilave, ministritë dhe agjencitë do të duhet të performojnë. Pra, ligji përkatës ka paraparë nxjerrjen e katër akteve nënligjore nga Qeveria duke u bazuar në këtë ligj. Tabela në vazhdim paraqet aktet nënligjore të parapara me ligj dhe nëse të njëjtat janë hartuar dhe miratuar nga Qeveria.

Tabela 1: nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore nga Qeveria sipas ligjit përkatës

Nr.	Akti nënligjor i paraparë me ligj	Rezultati
1	Rregullore për standardet e organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura	Miratuar nga Qeveria më 31 janar 2020 ⁷
2	Rregullore për hartimin dhe formatin e planit të performancës, raportit dhe deklaratës së performancës	Miratuar nga Qeveria më 31 janar 2020 ⁸
3	Rregullore për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura	Përfshirë në Rregulloren 1 më lartë
4	Rregullore për organizimin e strukturave përgjegjëse për funksionet e brendshme administrative të ministrisë	Përfshirë në Rregulloren 1 më lartë

Sipas tabelës së dhënë më sipër, mund të thuhet se Qeveria ka miratuar dy rregullore nga katër të parapara me ligj, mirëpo ka përfshirë (mbuluar) edhe materiet e dy rregullore tjera që janë paraparë me ligj (rregulloret nën 3 dhe 4 në tabelën sipër) në një rregullore të vetme. Kjo ngase fusha

e bashkëpunimit në mes të institucioneve të administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura dhe organizimi i strukturave për funksionet e brendshme administrative janë mbuluar me Rregulloren për standardet e organizimit të brendshëm në këto institucione.

⁷ Rregullore nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura: <https://bit.ly/3mYfZ1b>

⁸ Rregullore nr. 03/2020 për performancën e agjencive: <https://bit.ly/2GkNĒIm>

Adresimi nga Qeveria/ministria përgjegjëse për administratë publike i obligimeve programore që kërkohen me ligj

Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura parasheh në parim tri obligime madhore për Qeverinë dhe ministrinë përgjegjëse për administratën publike.

Tabela 2: Obligimet tjera që dalin nga ligji përkatës, institucioni përgjegjës dhe rezultati

Obligimi	Institucioni përgjegjës	Rezultati
Miratimi i Planit të Veprimit për racionalizimin e agjencive	Qeveria	Miratuar në Qeveri ⁹
Miratimi i metodologjisë për përgatitjen e propozimit për krijimin, bashkimin dhe shuarjen e agjencive	Ministria përgjegjëse për administratë publike	/
Modernizimi i vazhdueshëm i administratës shtetërore	Ministria përgjegjëse për administratë publike	Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 miratuar në Qeveri ¹⁰

Sa i përket metodologjisë për përgatitjen e propozimit për krijimin, bashkimin dhe shuarjen e agjencive, një metodologji e tillë nuk ekziston si një dokument i ndarë. Megjithatë, në bazë të hapave të përcaktuar në çdo fazë të racionalizimit të agjencive sipas planit për racionalizimin e tyre, mund të thuhet që procedura që ndjek një propozim i tillë del nga rishikimi i agjencive. Pra, sipas rezultateve të rishikimit, një agjenci mund të transferohet, mund të shuhet, të bashkohet me një tjetër dhe secila formë duhet të pasohet me hartimin e një koncept dokumenti për ndryshimin e ligjit përkatës ngase të gjitha agjencitë janë të themeluara me ligje të veçanta apo sektoriale.

⁹ Plani i veprimit për racionalizimin e agjencive: <https://bit.ly/33bKV6k>

¹⁰ Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020: <https://bit.ly/36jp8vo>

Racionalizimi i agjencive

Plani i veprimit për racionalizimin e agjencive është miratur në Qeveri në korrik 2018¹¹ ngase racionalizimi i agjencive është kërkuar vazhdimisht nga raportet për vendin të Komisionit Evropian në vitet 2015 e tutje, Agjenda për Reforma Evropiane e vitit 2016 dhe Kontrata për Mbështetje Buxhetore Sektoriale e nënshkruar në mes të Qeverisë dhe Komisionit Evropian. Plani i veprimit është i ndarë në katër faza sipas katër grupeve të agjencive dhe me përjashtim të fazës së parë, tri fazat tjera përfshijnë së pari rishikimin e agjencive e pastaj hartimin e koncept dokumentit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve të veçanta të agjencive sipas rishikimit paraprak.

Sipas komunikimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme (përgjegjëse për administratën publike), sa i përket grupit të parë të agjencive (apo fazës së parë), plani është që këto agjenci të kalojnë në kuadër të Qeverisë sepse tipe të tilla të agjencive në vendet e BE-së funksionojnë në kuadër të Qeverisë dhe jo nën Kuvend. Në kuadër të kësaj, sipas Programit legjislativ të Qeverisë për vitin 2020, projektligji për ndërrimin e vijave të llogaridhënies për këtë grup të agjencive (pra nga Kuvendi nën Qeveri) është paraparë të miratohet në Qeveri më 30 shtator 2020.¹² Ky grup i agjencive përfshinë agjenci që aktualisht janë nën Kuvendin e Kosovës, grupet dy dhe tre përbëhen nga agjenci ekzekutive në kuadër të ministrive kurse grupi i katërt (apo faza e katërt) përbëhet nga agjenci të pavarura rregullatore që raportojnë në Kuvendin e Kosovës. Koncept dokumenti për hartimin e ligjit për ndërrimin e vijave të llogaridhënies së agjencive të grupit të parë ka kaluar fazat e konsultimeve të brendshme dhe publike në korrik 2018¹³ kurse vet ligji i bazuar në këtë koncept dokument ka kaluar këto faza në prill 2019¹⁴ mirëpo ende nuk është miratuar në Qeveri për të kaluar pastaj për miratim final në Kuvend të Kosovës.



PLANI I VEPRIMIT ËSHTË I NDARË NË KATËR FAZA SIPAS KATËR GRUPEVE TË AGJENCIVE DHE ME PËRJASHTIM TË FAZËS SË PARË, TRI FAZAT TJERA PËRFSHIJNË SË PARI RISHIKIMIN E AGJENCIVE E PASTAJ HARTIMIN E KONCEPT DOKUMENTIT PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E LIGJEVE TË VEÇANTA TË AGJENCIVE SIPAS RISHIKIMIT PARAPRAK.

11 Vendimi nuk është publik tek vendimet e Qeverisë në vitin 2018.

12 Programi legjislativ i Qeverisë i plotësuar së fundit me 9 shtator 2020, f. 11: <https://bit.ly/3mZJolo>

13 Shih draft koncept dokumentin dhe dokumentet tjera në platformën e konsultimeve publike: <https://bit.ly/2ldldidn>

14 Shih draft ligjin dhe dokumentet tjera në platformën për konsultime publike: <https://bit.ly/2SFpsN1>

Hartimi dhe miratimi i Rregulloreve për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizim të Vendeve të Punës në Ministri dhe Agjenci ekzekutive

Hartimi dhe miratimi i Rregulloreve për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizim të Vendeve të Punës në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura është obligim apo detyrë që del nga ligji përkatës. Për të mësuar nëse institucionet përkatëse kanë hartuar dhe miratuar këto rregullore, janë dërguar kërkesa për qasje në dokumente publike në të gjitha ministrinë, agjencitë ekzekutive në kuadër të ministrive dhe zyrës së Kryeministrit. Sa i përket agjencive ekzekutive, tani me ligjin përkatës kërkohet që agjencitë ekzekutive të kenë rregullore për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës ndaras nga ministria amë. Pra për këtë qëllim, pyetjet i janë drejtuar ndaras ministrisë dhe agjencisë në kuadër të ministrisë përkatëse. Po ashtu, miratimi i rregulloreve është i ndarë me qëllim që plotësim/ndryshimi i njëjës të mos implikojë plotësim/ndryshimin e komplet rregullores e cila përfshinë ministrinë dhe agjencitë ekzekutive në kuadër të ministrisë.

Pyetja që i është drejtuar të gjitha ministrive dhe agjencive ekzekutive në kuadër të tyre lidhet me atë nëse kanë hartuar rregulloren përkatëse dhe në cilën fazë është procesi deri në miratimin në Qeveri, dhe nëse nuk ka filluar të hartohet, cilat janë pengesat në këtë proces.

“

MIRATIMI I RREGULLOREVE ËSHTË I NDARË ME QËLLIM QË PLOTËSIM/NDRYSHIMI I NJËRËS TË MOS IMPLIKOJË PLOTËSIM/NDRYSHIMIN E KOMPLET RREGULLORES E CILA PËRFSHINË MINISTRINË DHE AGJENCITË EKZEKUTIVE NË KUADËR TË MINISTRISË.

Ministrinë

Nga 16 ministri gjithsej, vetëm Ministria e Mbrojtjes ka hartuar dhe miratuar në Qeveri rregulloren përkatëse,¹⁵ gjashtë ministri nuk kanë kthyer përgjigje derisa nëntë ministri janë në faza të ndryshme në këtë proces.

Tabela 3: Procesi i hartimit deri në miratim të rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në ministri

Ministria	Nuk ka filluar	Në grup punues	Në konsultime	Miratuar në Qeveri	Pa përgjigje
1 Ministria e Drejtësisë		✓			
2 Ministria e Punëve të Brendshme			✓		
3 Ministria e Arsimit dhe Shkencës					-
4 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës					-
5 Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit		✓			
6 Ministria e Financave					-
7 Ministria e Bujqësisë					-
8 Ministria e Kulturës					-
9 Ministria e Mbrojtjes				✓ ¹⁶	
10 Ministria e Infrastrukturës		✓			
11 Ministria e Shëndetësisë		✓			
12 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale					-
13 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë			✓		
14 Ministria për Komunitete dhe Kthim		✓			
15 Ministria e Zhvillimit Rajonal			✓		
16 Ministria e Pushtetit Lokal			✓		

15 Rregullore nr. 07/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mbrojtjes: <https://bit.ly/2SB7330>

16 Vendimi nr. 10/97 i datës 11 prill 2019: <https://bit.ly/2Ha9s3f>

Agjencitë ekzekutive

Nga 46 agjencitë ekzekutive, asnjë prej tyre nuk e ka të miratuar rregulloren përkatëse, 16 agjenci nuk kanë kthyer përgjigje, në gjashtë të tjera ky proces nuk ka filluar ende, derisa në 23 agjenci tjera procesi është ose në kuadër të grupit punues ose në proces të konsultime paraprake ose publike. Instituti i Mjekësisë Ligjore ka deklaruar se ka hartuar

dhe miratuar rregulloren përkatëse, por rregullorja në fjalë nuk është e miratuar në Qeveri por vetëm e nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë.¹⁷ Pra kjo formë e miratimit të rregullores nuk është në harmoni me ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. Tabela në vazhdim paraqet agjencitë ekzekutive dhe statusin e përgjigjeve sipas pyetjeve të dërguara në çdo agjenci.

Tabela 4: Procesi i hartimit deri në miratim të rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në agjenci ekzekutive

Agjencia ekzekutive	Nuk ka filluar	Në grup punues	Në konsultime	Miratuar në Qeveri	Pa përgjigje	Tjetër
1 Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë			✓			
2 Agjencia për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore					-	
3 Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve			✓			
4 Agjencia e Kosovës për Standardizim					-	
5 Drejtoria e Akreditimit			✓			
6 Agjencia e Kosovës për Akreditim		✓				
7 Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve					-	
8 Agjencia për Pronësi Industriale			✓			
9 Avokatura Shtetërore		✓				
10 Inspektorati i Shëndetësisë					-	
11 Agjencia Qendrore e Prokurimit	✗					
12 Instituti i Kosovës për Administratë Publike			✓			

17 Rregullore nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institutin e Mjekësisë Ligjore: <https://bit.ly/3iD7Rji>

Agjencia ekzekutive	Nuk ka filluar	Në grup punues	Në konsultime	Miratuar në Qeveri	Pa përgjigje	Tjetër
13 Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë			✓			
14 Agjencia për Barazi Gjinore	X					
15 Agjencia e Metrologjisë					-	
16 Njësia e Inteligjencës Financiare	X					
17 Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve					-	
18 Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar		✓				
19 Agjencia e Financimit Shëndetësor	X					
20 Agjencia për Pajisje dhe Produkte Mjekësore		✓				
21 Shërbimi Gjeologjik		✓				
22 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë					-	
23 Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë		✓				
24 Inspektorati i Tregut					-	
25 Agjencia e Statistikave e Kosovës	X					
26 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë		✓				
27 Doganat e Kosovës					-	
28 Administrata Tatimore e Kosovës			✓			
29 Thesari		✓				

Agjencia ekzekutive	Nuk ka filluar	Në grup punues	Në konsultime	Miraturar në Qeveri	Pa përgjigje	Tjetër
30 Shërbimi Korrektues		✓				
31 Shërbimi Sprovues		✓				
32 Agjencia e Menaxhimit Emergjent					-	
33 Agjencia e Kosovës për Forenzikë	X					
34 Akademia e Kosovës për Siguri Publike					-	
35 Agjencia Kadastrale e Kosovës			✓			
36 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës			✓			
37 Agjencia e Punësimit					-	
38 Inspektorati i Punës		✓				
39 Agjencia për Shoqërinë e Informacionit					-	
40 Instituti i Mjekësisë Ligjore						✓ ¹⁸
41 Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës		✓				
42 Agjencia Pyjore e Kosovës					-	
43 Agjencia për Shërbimet e Navigimit Ajror					-	
44 Agjencia e Regjistrimit Civil					-	
45 Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës		✓				
46 Inspektorati Policor i Kosovës					-	

18 Rregullorja përkatëse e Institutit të Mjekësisë Ligjore nuk është e miraturar në Qeveri, por vetëm e nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë me datë 01.07.2020.

Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme (përgjegjëse për administratë publike), deri tani kanë kërkuar pëlqimin disa institucione si Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Agjencia për Informim dhe Privatësi, Agjencia e Metrologjisë e Kosovës (AMK), Inspektorati i Arsimit dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), mirëpo ende nuk është dhënë pëlqimi mbi rregulloret për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës për to.¹⁹ Në anën tjetër, sipas Ministrisë së Financave, deri tani në këtë institucion kanë kërkuar pëlqim vetëm Inspektorati i Arsimit dhe KRPP-ja dhe pëlqimi është dhënë për rregulloret e këtyre dy institucioneve.²⁰

Në bazë të përgjigjeve që kanë dhënë agjencitë ekzekutive, vërehet se ministrinë dhe agjencitë brenda tyre nuk e kanë të qartë se më këtë ligj kërkohet që të dyja të hartojnë rregullore ndaras²¹ dhe procedura e miratimit të tyre është po ashtu e ndarë. Miratimi i tyre kërkon pëlqimin paraprak të dy ministrive, ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe Ministrisë së Financave e pastaj rregullorja pas miratimit duhet të nënshkruhet nga Kryeministri.²² Për shembull, Avokatura Shtetërore dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës janë agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, mirëpo përgjigjen për to e ka dhënë Ministria e Drejtësisë mbi atë se rregullorja për organizimin e brendshëm është duke u hartuar nga grupi punues, që në fakt nënkupton që përmes rregullores për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë do të adresohet edhe organizimi i brendshëm i të dy agjencive.²³ E njëjta logjikë vlen edhe për Agjencinë Qendrore të Prokurimit si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Financave. Sipas përgjigjes së pranuar nga agjencia në fjalë, një zyrtar është dërguar nga kjo agjenci në grupin punues në kuadër të Ministrisë së Financave dhe kjo do të thotë që përmes rregullores për organizimin e ministrisë është menduar të adresohet edhe organizimi i brendshëm i

agjencisë në fjalë.²⁴ Në këtë rend hyn edhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike, ku sipas përgjigjes së dhënë bëhet fjalë për rregulloren për organizim të brendshëm në nivel të ministrisë dhe përmes saj të adresohet edhe organizimi i brendshëm i institutit.²⁵

Në anën tjetër, sipas përgjigjes dhe rregullores së dërguar nga Agjencia për Barazi Gjinore e cila thirret në rregulloren për organizimin e brendshëm të miratuar në vitin 2016, vërehet se agjencia nuk ka njohuri për ndryshimin e ligjit përkatës për administratën shtetërore dhe se agjencia do të duhet të nxjerrë një rregullore tjetër duke u bazuar në ligjin aktual i cili ka hyrë në fuqi me 1 prill 2019. Po ashtu, një element tjetër i përmendur më lartë lidhur me Institutin e Mjekësisë Ligjore,²⁶ sipas përgjigjes së dërguar, vërehet se instituti nuk është në dijeni që rregullorja për organizim të brendshëm të agjencisë miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri dhe jo nga Ministri i ministrisë përkatëse. Në fakt, ky i fundit duhet të jap pëlqimin se rregullorja e agjencisë është në rregull para marrjes së pëlqimeve nga ministrinë përgjegjëse për administratë publike dhe ministrisë së financave por nuk është autoriteti i fundit pas miratimit të të cilit, akti nënligjor hyn në fuqi.

19 Takim me Malsore Gashi, Ministria e Punëve të Brendshme, datë 9 tetor 2020.

20 Takim me Milaim Aliu dhe Arta Maxhuni, Ministria e Financave, datë 14 tetor 2020.

21 Shih Nenin 9, pika 2 e Rregullores 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura: <https://bit.ly/30M2tV7>

22 Shih Nenin 9, pika 7 e të njëjtës rregullore.

23 Sipas përgjigjeve të pranuar nga dy agjencitë me datë 18 shtator.

24 Sipas përgjigjes së pranuar me datë 22 shtator.

25 Sipas përgjigjes së pranuar me datë 18 shtator.

26 Sipas përgjigjes së pranuar me datë 29 shtator.

Agjencitë e pavarura

Agjencitë e pavarura të cilat janë përfshirë në këtë punim janë ato të themeluara në bazë të Nenit 142 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht nuk përfshinë institucionet e pavarura si Këshilli i Pavarur Gjyqësor, Këshilli i Pavarur Prokurorial, Gjykata Kushtetuese, etj., dhe ato të listuara në Kapitullin XII të Kushtetutës.²⁷

mirëpo jo duke u bazuar edhe në ligjin përkatës derisa në tetë agjenci tjera, ky proces është qoftë në grup punues qoftë në fazën e konsultimeve të brendshme apo publike.

Hartimi dhe miratimi i Rregulloreve për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizim të Vendeve të Punës

Për dallim nga ministrinë dhe agjencitë ekzekutive, rregulloret e të cilave miratohen në Qeveri pas pëlqimeve paraprake të dy ministrive të cekura më lartë, rregulloret për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të agjencive të pavarura miratohen nga titullari i agjencisë (drejtori) apo nga organi kolegjial (bordi/këshilli/komisioni), nëse agjencia qeveriset nga një organ kolegjial. Mirëpo, para miratimit, bazuar në Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, kërkohet mendimi këshillimor i të dy ministrive dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA).²⁸ Pra, në rastin e agjencive të pavarura, mendimi nuk është detyrues por vetëm këshillimor dhe përveç dy ministrive, mendimi përkatës kërkohet edhe nga ZKA.

Në bazë të përgjigjeve të pranuar nga agjencitë e pavarura dhe hulumtimit në këtë aspekt, rregullore të brendshme për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës duke u bazuar edhe në ligjin përkatës (përveç duke u bazuar në ligjin e veçantë me të cilin është themeluar agjencia), nuk ka miratuar asnjë agjenci e pavarur. Në anën tjetër, pesë agjenci tjera nuk kanë kthyer përgjigje, dy agjenci nuk kanë filluar ende këtë proces, dy të tjera i kanë miratuar rregulloret



BAZUAR NË LIGJIN PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE AGJENCIVE TË PAVARURA, KËRKOHEM MENDIMI KËSHILLIMOR I TË DY MINISTRIVE DHE ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA).

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, shih nenet 132 – 142.

²⁸ Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Neni 42, pika 4.

Tabela 5: Procesi i hartimit deri në miratim të rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në agjenci të pavarura

Agjencia e pavarur	Nuk ka filluar	Në grup punues	Në konsultime	Miratuar	Pa përgjigje	Tjetër
1 Autoriteti Rregullator i Hekurudhave		✓				
2 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	X					
3 Zyra e Rregullatorit për Energji					-	
4 Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare					-	
5 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës					-	
6 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik			✓			
7 Agjencia për Informim dhe Privatësi		✓				
8 Agjencia Kundër Korrupsionit						✓
9 Organi Shqyrtues i Prokurimit		✓				
10 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale						✓
11 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore					-	
12 Agjencia për Ndhime Juridike Falas		✓				
13 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale		✓				
14 Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës		✓				
15 Agjencia Kosovare e Privatizimit		✓				
16 Autoriteti i Aviacionit Civil						✓
17 Trusti i Kursimeve Pensionale	X					

Sipas MPB, MF dhe ZKA²⁹ ku agjencitë e pavarura duhet të marrin mendimin këshillimor para miratimit të rregulloreve për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, nga grupi i agjencive të pavarura, vetëm KRPP dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi kanë kërkuar mendim këshillimor deri tani. Derisa sipas MPB, mendimi këshillimor në rastin e KRRP ende nuk është dhënë nga kjo ministri, MF dhe ZKA kanë deklaruar se mendimi këshillimor është dhënë pozitiv sa i përket rregullores së KRPP-së dhe se e njëjta pritet të miratohet në KRPP. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) dhe Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale (AMKM) kanë deklaruar se kanë miratuar rregulloret përkatëse, mirëpo dy ministrinë dhe ZKA nuk kanë cekur faktin që të njëjtat kanë kërkuar mendim këshillimor nga to. Sipas kësaj, del që të dy agjencitë i kanë miratuar këto rregullore pa mendimin këshillimor të dy ministrive dhe ZKA. Për më shumë, nga një analizë e bazës ligjore të cekur në rregulloret e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në AKK³⁰ dhe AMKM³¹, asnjëra prej tyre nuk i referohet edhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura edhe pse të dy janë miratuar pas hyrjes në fuqi të ligjit në fjalë.

Hartimi dhe miratimi i planeve vjetore të performancës të agjencive të pavarura sipas ligjit

Sa i përket hartimit të planit vjetor të performancës për vitin 2020 dhe miratimit të tij nga komisioni përgjegjës,³² ligji përkatës është i qartë.

Sipas tij, çdo agjenci e pavarur harton dhe i propozon komisionit përgjegjës planin vjetor të performancës për vitin e ardhshëm deri me 30 nëntor. Pastaj, plani vjetor i performancës miratohet në bazë të një procesi të dialogut nga komisioni përgjegjës deri me 31 dhjetor. Në bazë të përgjigjeve të pranuar nga agjencitë e pavarura, tre prej tyre nuk kanë plan të punës për 2020, tetë të tjera kanë hartuar plan të tillë derisa gjashtë të tjera nuk kanë kthyer përgjigje në këtë pikë.

“

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT (AKK) DHE AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE (AMKM) KANË DEKLARUAR SE KANË MIRATUAR RREGULLORET PËR KATËSE, MIRËPO DY MINISTRITË DHE ZKA NUK KANË CEKUR FAKTIN QË TË NJËJTAT KANË KËRKUAR MENDIM KËSHILLIMOR NGA TO.

29 Takim me Safet Berisha, Zyra Kombëtare e Auditimit, datë 16 tetor 2020.

30 Rregullore nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit nënshkruar nga Drejtori i agjencisë më 10.05.2019: <https://bit.ly/2SYKYMV>

31 Rregullore nr. 01/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale nënshkruar nga Drejtori i agjencisë më 11.10.2019: <https://bit.ly/355Rqr0>

32 Komisioni përgjegjës është komisioni i Kuvendit i cili mbikëqyrë veprimtarinë e agjencisë së pavarur.

Tabela 6: Agjencitë e pavarura që kanë hartuar dhe ato që nuk kanë hartuar plan të punës për 2020, përfshirë ato që nuk janë përgjigjur

Agjencia e pavarur	Plani i punës i hartuar		Pa përgjigje
	PO	JO	
1 Autoriteti Rregullator i Hekurudhave		X	
2 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	✓		
3 Agjencia Kundër Korrupsionit	✓		
4 Organi Shqyrtues i Prokurimit		X	
5 Agjencia për Ndihme Juridike Falas	✓		
6 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	✓		
7 Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	✓		
8 Agjencia Kosovare e Privatizimit	✓		
9 Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës	✓		
10 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik		X	
11 Agjencia për Informim dhe Privatësi			-
12 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	✓		
13 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor			-
14 Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës	✓		
15 Zyra e Rregullatorit për Energji			-
16 Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare			-
17 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës			-

Hartimi, miratimi dhe publikimi i raporteve vjetore të punës i agjencive të pavarura sipas ligjit

Sa i përket raportit vjetor të punës, agjencitë e pavarura janë pyetur nëse kanë hartuar raport të punës për vitin 2019, nëse i njëjti është miratuar në komisionin përgjegjës dhe nëse raporti është publik. Sipas tabelës në vijim, gjashtë agjenci të pavarura nuk kanë kthyer përgjigje, pesë agjenci kanë raportuar se raporti vjetor i tyre është diskutuar dhe miratuar

në komision dhe i njëjti është publikuar kurse raportet e katër agjencive të tjera nuk janë diskutuar, as miratuar dhe as nuk janë publikuar. Në anën tjetër, Autoriteti Rregullator i Hekurudhave ka deklaruar se raporti vjetor është diskutuar në komisioni, nuk është miratuar por i njëjti është publikuar. Pastaj, Trusti i Kursimeve Pensionale ka raportuar se raporti vjetor është diskutuar në komision, nuk është miratuar ende dhe se i njëjti ende nuk është publikuar. Zakonisht agjencitë e pavarura nuk bëjnë publike raportet të cilat ende nuk janë miratuar në komisionin përgjegjës parlamentar.

Tabela 7: Statusi i raportit vjetor në agjencitë e pavarura

Agjencia e pavarur	Raporti 2019 diskutuar në Komision		Raporti 2019 miratuar në Komision		Raporti është publik		Pa përgjigje
	PO	JO	PO	JO	PO	JO	
1 Autoriteti Rregullator i Hekurudhave	✓			✗	✓		
2 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	✓		✓		✓		
3 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	✓		✓		✓		
4 Agjencia për Informim dhe Privatësi							-
5 Agjencia Kundër Korrupsionit	✓		✓		✓		
6 Organi Shqyrtues i Prokurimit	✓		✓		✓		
7 Agjencia për Ndhme Juridike Falas		✗		✗		✗	
8 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale		✗		✗		✗	
9 Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës		✗		✗		✗	
10 Agjencia Kosovare e Privatizimit	✓		✓		✓		
11 Trusti i Kursimeve Pensionale i Kosovës	✓			✗		✗	
12 Zyra e Rregullatorit për Energji							-
13 Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare							-
14 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës							-
15 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale							-
16 Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor							-
17 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës		✗		✗		✗	

Rekomandime

Duke u bazuar në analizimin e situatës rreth zbatimit të **Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura**, rekomandimet në vijim jepen në funksion të zbatimit të ligjit:

Për Kuvendin e Kosovës:

- Komisioni për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal dhe Media duhet të:
 - ftojë Ministrin e Punëve të Brendshme në raportim mbi zbatimin e ligjit përkatës dhe të kërkoj raport të detajuar mbi zbatimin e tij deri tani, si dhe hapat e planifikuar që bien në përgjegjësi të tij sa i përket zbatimit të ligjit nga të gjitha institucionet;
 - përfshinë në plan vjetor të punës për 2021 zhvillimin e vizitave në disa institucione kyçe për zbatimin e ligjit për t'u njoftuar nga afër me zbatimin e tij;
 - kërkojë nga Qeveria zbatimin e Planit të Veprimit për Racionalizimin e Agjencive dhe të njëjtën kohë të tregojë gatishmërinë në racionalizimin e agjencive të pavarura që raportojnë në Kuvend sepse Plani i vep-

rimit për racionalizimin e agjencive përfshinë të tri tipet e agjencive, të pavarura, rregullatore dhe ekzekutive;

- Administrata e Kuvendit, përkatësisht njësia ku raportojnë agjencitë e pavarura, duhet të ofrojë udhëzime dhe këshilla ndaj agjencive të pavarura me qëllim ndjekjen e procedurave në hartim të planit vjetor të performancës dhe rregullat e reja sa i përket miratimit të planit vjetor të punës;

Për Qeverinë:

- Qeveria duhet të ketë vullnetin politik për reformën (racionalizimin) e agjencive ngase racionalizimi i agjencive është parakusht për krijimin e një administrate publike efektive dhe të organizuar sipas parimeve të njohura ndërkombëtarisht për organizim dhe funksionim të administratës publike;
- Qeveria duhet të vendos si një prej pikave prioritare plotësim/ndryshimin e Ligjit për zyrtarët publik, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbi të, e po ashtu edhe hartimin nga fillimi të Ligjit të pagave dhe të procedojë të dy projektligjet për miratim në Kuvend;

Për Ministrinë përgjegjëse për administratë publike:

- Ministria përgjegjëse për administratë publike duhet që në këtë fazë të organizojë punëtorët me qëllim prezantimin e kërkesave të ligjit për këto institucione, në mënyrë që këto të fundit të jenë më afër zbatimit të kërkesave të ligjit kur dërgojnë propozim rregulloret për pëlqime në ministrinë përkatëse;

Për agjencitë e pavarura:

- Agjencitë e pavarura duhet të marrin përgjegjësitë që dalin për to nga ky ligj, në kuptim të raportimit në Kuvend por edhe transparencës ndaj publikut;

Për agjencitë ekzekutive:

- Agjencitë ekzekutive duhet të nisin procedurat e hartimit të rregulloreve për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës, ndaras nga ministrinë dhe miratimi i tyre të kërkohej nga Qeveria;
- Agjencitë ekzekutive duhet të ndajnë punët me ministrinë ku ato bëjnë pjesë sipas parimeve të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e agjencive të pavarura. Sipas disa prej këtyre parimeve, ministria bën politika kurse agjencia i zbaton ato, ministria ofron shërbimet mbështetëse administrative për agjencitë me më pak se 50 punëtorë, etj. Në anën tjetër, agjencitë me më shumë se 50 punëtorë, duhet të ndjekin kërkesën e ligjit në kuptim të dedikimit jo më shumë se 25% e punëtorëve që punojnë në divizionet që përbëjnë shërbimet mbështetëse administrative;

Mbështetur nga:



Kingdom of the Netherlands